



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 2354 prot.

Tiranë, më 15/05/2020

URDHËR

Nr. 320, datë 15.05.2020

**“PËR DISA KUFIZIME NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE NË BARE, RESTORANTE
DHE LOKALE, FAST-FOOD”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 4, të Ligjit nr.15/201, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si dhe udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19 në Republikën e Shqipërisë,

URDHËR O J:

1. Ofrimin e shërbimit në bare, restorante dhe lokale, fast-food, në të gjithë vendin, duke filluar nga data 18 Maj, vetëm në mjediset e tyre të hapura, sipas orareve të përcaktuara në urdhërat përkatëse për secilën zonë, duke respektuar protokollat e sigurisë, të miratuar nga Instituti i Shëndetit Publik.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe subjektet që ushtrojnë aktivitetet e përcaktuara në pikën 1, të këtij Urdhri.
3. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor mbikëqyr zbatimin e Urdhrit dhe vendos masën e gjobës, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Urdhri Nr. 164, datë 12.03.2020 “Për mbylljen e bareve, restoranteve dhe lokaleve, fast-food dhe kufizimin e shërbimeve që ofrohen nga struktura akomoduese që ofrojnë shërbim për klientët” dhe çdo Urdhër tjetër që bie në kundërshtim me parashikimet e këtij Urdhri shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ogerta Manastirliu

